

## AKTI THEMELUES

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "EMIR STAR" SH.P.K



Ky akt themelues u perpilua nga ortaku themelues:

1. **MIRVJEN LAMÇE** i biri i Shpetimit i datelindjes 24 Shtator 1980, banues ne Tirane, i quajtur me poshte ortak themelues, i cili ne perputhje me ligjin Nr.7632, date 4.11.1992 " Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregtar", me ligjin Nr. 7638, date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare " dhe ligjin nr.7667, date 23/01/1993 "Per regjistrin tregetar".

#### 1. FORMIMI

Formimi i Shoqerise

Ortaku themelues, **MIRVJEN LAMÇE** me 100 % te kuotat te kapitalit formon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me kreun e katert te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 " Per shoqerite Tregtare".

##### 1.1 -Emri

Emri i Shoqerise do te jete " **EMIR STAR** " SH.P.K

##### 1.2- Objekti i shoqerise

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si vijon :  
Ndertime dhe sipermarrje per ndertime te konstruksioneve dhe veprave civile dhe publike te gjitha kategorive , Import - Eksport , tregetim me shumice e pakice te produkteve te ndryshem , industriale , elektroshtepiake , bizhuteri , manifaktura kimike tekstile , plastike , xhama materiale dhe lende gjysem te gatshme , artikuj sportive dhe argetues , materiale dhe paisje zyrash , materiale ndertimi , paisje dhe makineri elektrike , transporti , artikuj bujqesor dhe blegtorial , fruta perime , servise automjetesh , tregetim automjetesh dhe pjeseve te kembimit , dhe tregtim karburanti me pakice .

##### 1. - Adresa e Shoqerise

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane Ruga " Ismail Qemali " Pallati 2 K .Sipas vendimit te miratuar nga ortaku i vetem dhe ne perputhje me statutin e shoqerise ajo mund te hape degje, zyra, filiale ose perfaqesi te shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise .

##### 1.4 - Afati i veprimtarise se shoqerise

Afati i veprimtarise se shoqerise do te jete mbi 10 vjet . Si dite fillestare do te merret data e regjistrimit te saj ne Gjykaten e Tiranës. Ortaku i vetem ka te drejte ta zgjase kete afat.



## 1.5 - Kapitali

Kapitali themelor eshte 100.000 ( njeqind mije ) leke , kontribut i vetem i ortakut themelues MIRVJEN LAMÇE ne masen 100 % te kuotave te kapitalit themeltar.

## 1.6- Fitimi

Firmi i realizuar nga aktiviteti i shoqerise i takon ortakut te vetem themelues MIRVJEN LAMÇE ne masen 100%

## II - KAPITALI

### 2.1- Kontributet e kapitalit

Sasia e kapitalit te derdhur sipas pikes 1.6 te ketij Akti Themeltar do te quhet "KONTRIBUT KAPITALI", kontribut ky i ortakut te vetem themelues MIRVJEN LAMÇE ne masen 100 % . Ortaku i vetem themelues mund te ndryshoje kapitalin .

## III. STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

### 3.1- Organet e Shoqerise

- Ortaku i vetem themelues
- Admimstratori i shoqerise , detyre te cilen do ta krycje z. MIRVJEN LAMÇE

## IV. DISPOZITE E FUNDIT

4.1. Ndryshimet ne kete AKT mund te behen vetem me shtese me shkrim dhe te miratuar nga ortakut i vetem themelues.

Pjese e pandare e ketij akti eshte statuti i shoqerise i cili nenshkruset njekohesisht nga ortakut i vetem themelues.

4.2. Ky akt themelimi u hartua ne Tirane ne 4 kopje origjinale, i cili nenshkruset rregullisht konform ligjes.

## ORTAKU I VETEM

1. MIRVJEN LAMÇE

*Mirvjen Lamçe*  
*M.L.*

REPUBLIKA SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 5909 rep, Nr. 776 kol.



VERTETIM

Ne Tirane, sot me daten ....31/12.....2003 (Dymije e tre) ne zyren e noterise Tirane, para meje Notere ELIDA MAGANI , u paraqit personalisht: L.MIRVJEN LAMÇI i biri i Shpetimit i datelindjes 24 Shtator 1980 , banues ne Tirane , madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, Identifikuar me Pashaporten Z.0988018 i cili ka redaktuar kete Akt Themelimi me vullnetin e tij te lire dhe e nenshkruan rregullisht para meje dhe une noter e vertetoj sipas ligjit me nenshkrimin tim dhe vulen e noterit publik.

NOTERE  
ELIDA MAGANI



**STATUT**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "EMIR STAR "**  
**SILP.K**

Ky statut perpilohet nga :

**1. MIRVJEN LAMÇE** i biri i Shpetimit i datelindjes 24 Shtator 1980 , banues ne Tirane .I quajtur me poshte ortak themelues, i cili ne perputhje me ligjin Nr.7632, date 4.11.1992 " Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregtar", me ligjin Nr. 7638, date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare " dhe ligjin nr.7667, date 23/01/1993 "Per regjistrin tregetar", krijon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar , si vijon:

**KREU I :**

**FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA**

**NENI 1**

**FORMA**

Ortaku themelues krijon nje Shoqeri me Pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Shqiperi dhe me dispozitat e ketij Statuti.

**NENI 2**

**EMERTIMI I SHOQERISE**

Emertimi i Shoqerise do te jete "EMIR STAR " SILP.K

**NENI 3**

**SELIA E SHOQERISE**

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane Ruga "Ismail Qemali "Pallati 2 K .Sipas vendimit te miratuar nga ortakut i vetem dhe ne perputhje me statutin e shoqerise ajo mund te hapet degje, zyra, filiale ose perfaqesi te shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise .

**NENI 4**


**KOHEZGJATJA**

Shoqeria do te kete kohezgjatje mbi 10 vjet. Si date fillestare merret data e regjistrimit te saj ne Gjykatën e Tiranës.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJKATA E SHKALLES SE PARE  
TIRANE

TE VERIFIKOHET EMRI

Emir Stori

Mut ka EV...  


  
GJYOTARE  
REGJETA BANAJOTI



## NENI 5

### OBJEKTI I SHOQERISE

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si vijon :

Ndertime dhe sipermarrje per ndertime te konstruksioneve dhe veprave civile dhe publike te gjitha kategorie . Import – Eksport ; tregetim me shumice e pakice te produkteve te ndryshem , industriale , elektroshtepiake , bizhuteri , manufaktura kimike tekstile , plastike , xhama materiale dhe lende gjysem te gatshme , artikuj sportive dhe argetues , materiale dhe paisje zyresh , materiale ndertimi , paisje dhe makineri elektrike , transporti , artikuj bujqesor dhe blegtorial , fruta perime , servise automjesh , tregetim automjesh dhe pjeseve te kembimit , dhe tregtim karburanti me pakice .

## KREU II

### KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR DHE TRANSFERIMI

## NENI 6

### KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar eshte 100.000 ( njeqind mije ) leke.

## NENI 7

### KONTRIBUTET

2.1 Kontributet e kapitalit

Sasia e kapitalit te derdhur sipas pikes 1.6 te ketij Akti Themeltar do te quhet "KONTRIBUT KAPITALI", kontribut ky i ortakut te vetem themelues Mirvjen Lamce ne masen 100 % . Ortaku i vetem themelues mund te ndryshoje kapitalin .

## NENI 8

### NDARJA E FITIMIT

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqerise i rakon ortakut te vetem themelues ne masen 100%.

TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTKuotat e kapitalit te shoqerise mund te transferohen me ane aktesh mes te gjalleve dhe me trashegimi. Transferimi i kuotave te kapitalit te shoqerise duhet te behet me akt noterial



### KREU III

## MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE

### NENI 9

#### ORTAKU I VETEM

Ortaku i vetem organizon, drejton dhe kontrollon gjithë aktivitetin e shoqerise. Ortaku i perballojne humbjet e shoqerise deri me kufirin e vleres se kontributit te tij.

### NENI 10

#### DREJTIMI SHOQERISE

Organi me i larte drejtues i shoqerise do te jete Ortaku i vetem

### NENI 11

#### KOMPETENCAT E ORTAKUT TE VETEM

Ortaku i vetem vendos per keto ceshtje:

- Emeron administratorin e shoqerise.
- Emeron ekspertet kontabel.
- Miraton bilancin vjetor.
- Vendos per shperndarjen e dividendit te shoqerise.
- Ben ndryshime ne statut.
- Vendos per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar.
- Vendos per shperndarjen e shoqerise.
- Ne rast te shperndarjes se shoqerise cakton likuidatorin dhe e shkarkon ate kur perfundon likuidimi.
- Vendos per çdo problem tjetër që i vihet ne rend te dites.
- Vendimet e nenshkruara nga ortaku i vetem vertetohen nga noteri

### NENI 12

**ADMINISTRATORI** : Shoqeria do te administrohet nga Z. MIRVJEN LAMÇE

### NENI 13

#### KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Per realizimin e aktivitetit te shoqerise dhe zbatimin e vendimit te ortakut , administratori do te shperndaje dhe shperndaje te shprehur per problemet e shoqerise. Administratori

autorizon per ta perfaqesuar edhe nje person te trete. Administratori ka keto kompetenca:

- Te beje drejtimin e shoqerise .
- Te perpilojne dhe nenshkruaje kontratat dhe çdo akt tjeter juridik qe ka te beje me veprimtarine e shoqerise;
- Te hapi llogari rrjedhese bankare prane bankave shqiptare ose te huaja.
- Te depozitojne e te terheqe shuma parash;
- Te perfaqesoje shoqerine ne mardhenie me te tretet .
- Te bejne gjithçka tjeter qe konsideron te dobishme dhe qe eshte ne perputhje me formen e ketij Statuti e te Aktit Themelues si dhe me legjislacionin shqiptar ne fuqi, per te arritur qellimin dhe objektin e shoqerise.

#### KREU IV

### LIBRAT E LLOGARISE, BILANCI, FITIMI, SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

#### NENI 14

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacinit kontabel qe kerkon legjislacioni ne fuqi edhe keto libra :

- 1- Libri i ortakut te vetem ne te cilin shenohen emri i plote i Ortakut dhe kuotat qe ai ka ne kapitalin e themelimit.
- 2- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te Ortakut te vetem
- 3- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te Admimstratorit.

#### NENI 15

### VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, EKSPERTET KONTABE

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht viti i pare financiar mund te filloje pas regjistrimit te shoqerise si person juridik dhe do te perfundoje me 31 Dhjetor 2004.

Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operationet e vecanta te hartuara nga admimstratori miratohen nga ortaku i vetem .

Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

Shoqeria do te jete e kontrolluar nga nje organ i perbere prej nje ekspert kontabel i emeruar dhe nga Ortaku i vetem .

Ai do te funksionoje sipas kerkesave te nenit 69 te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992







## NENI 16 ZGJATJA E AFATIT

Zgjatja e afatit të shoqërisë që është përcaktuar në këtë statut, mund të vendoset nga ortakut i vetëm. Në rast se në shoqëri pranohen ortakë të tjerë konform legjislacionit në fuqi, atëherë vendimet merren me shumicën e ortakëve që zoterojnë mbi 3/4 e pjesëve të kapitalit themeltar.

## KREU V

### NENI 17

#### AKTIVITETI FINANCIAR

Në çdo mbyllje çdo viti financiar administratori bën inventarin dhe llogarinet vjetore në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për kontabilitetin, si dhe hartohet një raport me shkrim.

Bilancit i bashkëngjiten:

- Një situacion mbi garancitë e dhëna nga shoqëria,
- Një situacion mbi sigurimet e bera nga shoqëria,

Raporti i administratorëve përfshijë gjendjen gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e mundshme që janë zhvilluar nga data e mbylljes së vitit financiar deri në ditën që është hartuar ky raport.

Dokumentet vihen në dispozicion të ekspertëve kontabel të autorizuar, të pakten një muaj para mbledhjes së Ortakut të vetëm.

### NENI 18

Fitime neto të shoqërisë do të konsiderohen fitimet që rezultojnë pas zbritjes nga të ardhurat e të gjitha shpenzimeve që kanë lidhje me aktivitetin e shoqërisë, detyrimet fiskale, sigurimet shoqërore, dëmtimet, amortizimet, etj në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqëria krijon fondin rezerve dhe fonde të tjera të veçanta financimi.

Perberja, shumat e përgjithshme, burimet për krijimin e fondit rezerve, përdorimi dhe rregullimi i të çdo fondi të veçantë caktohet nga ortakut në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Në përputhje me Nenin 213 të ligjit "Për shoqëritë tregtare" nga fitimi i rezervuar gjatë vitit financiar libet mënjane një shumë me vlerë 1/20 e cila destinohet për krijimin e një fondi "rezerve e domosdoshme".

### NENI 19 PRISHJA E SHOQËRISË

Shoqëria priset me kalimin e afatit të caktuar në statut. Për arsye që parashikohen në ligj. Shoqëria priset përpara afatit me vendim të ortakut të vetëm.

#### NENI 20

Rastet e pavlefshmerise se shoqerise ose te nje akti qe ndryshon statutin si dhe bashkimi dhe ndarja e shoqerise behet ne perputhje me dispozitat e ligjit "per Shoqerite Tregtare".

#### NENI 21

Kur shoqeria prishet ajo kalon ne likujdim dhe ne kete rast emeritimit te shoqerise i shtohet shenimi " Shoqeri ne likujdim e siper ". Shoqeria edhe gjate procesit te likujdimit vazhdon si person juridik deri ne perfundimin e procesit te likujdimit. Prishja e shoqerise eshte me pasoje ndaj te treteve vetem pas publikimit te prishjes ne regjistrin tregtar.

#### NENI 22

Per te perfunduar procesin e likuidimit, Ortaku i vetem emerone nje ose disa persona si likujdues te cilet perfaqesojne shoqerise. Likuiduesi perpilon bilancin financiar likujdon tek te tretet detyrimet e shoqerise, shet aktivet e shoqerise dhe ndan tepricat ne dispozicion.

#### NENI 23


Ne perfundim te mbylljes se likujdimit, ortaku vendos per bilancin financiar perfundimtar, per aktin e rregullshmerise, per administrimin e tij nga ana e likujduesit dhe per heqjen e mandatit te likuiduesit, si dhe per t'u evidencuar mbyllja e likuidimit. Dokumentat e mesiperme miratohen nga ortaku i vetem .

#### NENI 24

Kur shoqeria likujdohet pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, i kthehet pronarit .

#### NENI 25 DISPOZITA TE FUNDIT

Shoqeria ka te drejte te punesoje punonjes qe i nevojiten per te ushtruar veprimtarine e saj. Punesimi behet sipas kushteve te percaktuara ne legjislacionin e punes se Republikes se Shqiperise, si dhe rregullave te vena ne kontraten e vecante te punesimit qe lidhet midis punedhenesit e punonjesit.



Shoqëria u garanton punonjesve kushte pune dhe mjete te nevojshme per realizimin e detyres qe kryejne.

#### NENI 27

Te gjitha problemet qe do te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private te kesaj do te zgjidhen sipas rregullave te percaktuara ne statutin dhe legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Kur mosmarreveshjet nuk zgjidhen ne mirekuptim kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e shkalles se pare Tirane.

#### NENI 28

Ky statut firmoset me vullnetin e lire te ortakut te vetem themelues.

Ortaku i vetem

MIRVJEN LAMÇE

*Mirvjen Lamçe*  
*ML*